



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. TONI GOGU



Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 97, datë 26.08.2019

Kryetari Bashki

Z. LIMJON VELIAJ



DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË

PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA TIRANË

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 01, datë 23.10.2019

DPPZHT: Z. LIMJON BABOÇI



PËRGATITI

AUTOR

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
Drejtoria e Planifikimit të Territorit,
Bashkia Tiranë.

UDHËHEQËS TË PROCESIT:

Ditjon Baboçi, Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Anisa Mançe, Drejtor
Drejtoria e Planifikimit të Territorit

Devis Agaraj, Përgjegjës Sektori
Sektori i Makroplanifikimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit

GRUPI I PUNËS:

Soviela Shehu
Sektori i Makroplanifikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Iva Tavanxhiu
Sektori i Makroplanifikimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Elda Maçi
Sektori GIS, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave

Enton Punavija, Drejtor
Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor



Tabela e përbajtjes

KREU I.....	5
NDRYSHIME NË RREGULLORE	5
KREU II.....	12
NDRYSHIME NË HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS DHE NË TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTURORE.....	12
KREU III.....	49
NDRYSHIME TË KOORDINATAVE TË POLIGONEVE, PA NDRYSHIME TË % SË PËRDORIMIT TË TOKËS, BREND A NJËSIVE STRUKTURORE.....	49
KREU IV	54
NDRYSHIME TË KUFIJVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE.....	54
KREU V.....	55
NDRYSHIME TË HARTËS SË RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR SIPAS KATEGORIZIMIT TË KODIT RRUGOR	55
<i>SHTOJCA I - Paraqitura e ndryshime në "Hartën e përdorimit të tokës" dhe "Hartën e hapësirave publike të propozuara"</i>	<i>57</i>
<i>SHTOJCA II - Paraqitura e ndryshimeve të koordinatave të poligoneve të përdorimit të tokës, brenda njësive strukturore dhe kufinjve të njësive strukturore</i>	<i>57</i>
<i>SHTOJCA III - Paraqitura e ndryshime të kufirit të njësive administrative të Bashkisë së Tiranës.</i>	<i>57</i>
<i>SHTOJCA IV - Paraqitura grafike e ndryshimeve në "Hartën e rrjetit rrugor të propozuar sipas kategorizimit të kodit rrugor"</i>	<i>57</i>





KREU I
NDRYSHIME NË RREGULLORE

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1 DATË, 14.04.2017 TË
KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, NË “RREGULLOREN E PLANIT TË
PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË TIRANË”**

Në faqen 2 (dy) të rregullores vendore shtohet teksti si vijon:

“Autorësia dhe kontributet

Kjo rregullore në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Tiranës është konceptuar dhe realizuar nga Devi Agaraj, Përgjegjës Sektori, Sektori i Makroplanifikimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Tiranë.

Kontribuan: Corrado Longa (SBA), Andreas Faoro (UNLAB) dhe Enton Punavija, Drejtor, Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Bashkia Tiranë.”

Në “Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- **NENI 1**

Në pikën 3, të nenit 1, hiqet fjala “dy” dhe shtohet fjala “këtyre”.

- **NENI 2**

Në pikën 3, të nenit 2, pas fjalëve “...nënshtrohet rishikimit...” shtohen fjalët “...të plotë..”.

- **NENI 3**

Në pikën 1, të nenit 5, bëhen këto ndryshime:

Në gërmë “n”, hiqen fjalët “kjo rregullore përcakton” dhe shtohen fjalët “përcaktohen nga kjo rregullore dhe përfshijnë kategoritë e zhvillimeve të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të, në përputhje me propozimin e Planit të Përgjithshëm”.

Pas gërmës “n”, shtohet pika “o” me këtë përbajtje: ““Strukturë” – është termi që përdoret për të përkufizuar çdo element artificial të ndërtuar apo ndërtueshëm, që krijon vëllim në territor”.

Gëрма “o” bëhet gëрма “p”, e në vijim, gërmat “p, q, r, s” ndryshohen respektivisht në gërmat “q, r, s, t”.

Në gërmën “r”, pjesa e parë e fjalisë me përbajtje: “...është termi që përdoret për identifikimin e hapësirave të pandërtuara ndërmjet strukturave,..” ndryshohet si vijon “është termi që përdoret për identifikimin e hapësirave të pandërtuara me objekte qe paraqesin situatë të formuar, ndërmjet strukturave,..”

Pas gërmës “t”, shtohet pika “u” me këtë përbajtje: ““Kushte” – kushte zhvillimi apo kushte proceduriale, nënkuuptojnë përkufizimet teknike apo ligjore të nevojshme për të vlerësuar apo ndërhyrë në territor”, dhe gëрма “v” me këtë përbajtje: ““Situatë e formuar” – nënkupton situatën ekzistuese urbane apo mijedisore, e cila ka

realizuar parashikimet e këtij plani apo të kuadrit teknik dhe ligjor në fuqi për të ardhmen e asaj pjese territorial”.

Gërmat “t” dhe “u” ndryshojnë emërtim respektivisht në gërmat “ë” dhe “x”

- **NENI 4**

Në nenin 11, bëhen këto ndryshime:

Pas shkronjës “ç”, të pikës 3, korrigohet renditja nga pika ”dh” në pikën ”d”

Në pikën 4, të nenin 11, pas fjalëve “...heqja e zonave të mbrojtura...” shtohen fjalët “...reflektim të gjëndjes ekzistuese të formuar, apo nevoja e përdorimit të territorit për realizimin e një projekti me interes publik nëpërmjet partneritetit publik-privat,...”.

- **NENI 5**

Gërma “c”, e nenin 12, ndryshohet si vijon:

“Aktivitetet e zonës rurale, pavarësisht shkallës, të tilla si rritja e bletëve, mbajtja e bagëtive dhe gjedhëve, etj., të ngjashme, janë të ndaluara në territorin e hierarkisë urbane. Lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe hortikulturës dhe frutikulturës në oborret dhe kopshet individuale të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane.”.

- **NENI 6**

Në pikën 1, të nenin 21, pas fjalëve “...dhe historike (M)...” shtohen fjalët “...për konservim...”.

- **NENI 7**

Pas shkronjës “d”, në pikën 6, të nenit 28, shtohet pika “e” me këtë përmbajtje: “Në të gjitha rastet, përzierja e përdorimeve sipas parashikimeve të këtij neni të jetë në përputhje edhe me parashikimet e nenit 10 të kësaj rregullore”.

- **NENI 8**


Në nenin 32, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 2, hiqen fjalët “menaxhohen dhe zhvillohen”.

Në pikën 3, në fund, hiqet fjala “zhvillimi” dhe shtohet fjala “vendore”.

Pas pikës 4, shtohet pika 5 këtë përmbajtje: “Në njësitë strukturore ku Plan i Përgjithshëm Vendor ka identifikuar “hapësira të hapura”, sipas hartës përkatësë dhe nenit 38/5 të kësaj rregullore, do të rezervohen të drejta zhvillimi për pronat private, duke i identifikuar si zona “T” (transferimi), të cilat do të mundësojnë në perspektive Transferimin e të Drejtës për Zhvillim për këto zona të identifikuara si të tillë. Gjatë hartimit të PDV-së, zona “T” mund të përcaktohen edhe ato zona të cilat për arsyte urbanistike apo gjeografike e kanë të pamundur realizimin e zhvillimit në hapësirën urbane në të cilën ndodhen. Në këto raste, të drejtat e zhvillimit do t'u rezervohen me kushtin e transferimit në përspektivë sipas një programi të realizuar nga Bashkia Tiranë në rastet e detyruara për transferim, në zbatim të legjislacionit përkatës për të drejtën e zhvillimit, apo përdorimit në zhvillime të cilat shprehin interesin të bashkëpunojnë për menaxhimin e përbashkët të një zone “T” nëpërmjet menaxhimit të vullnetshëm të tyre. Në rastet kur zhvillimi i kërkuar prek hapësirën nëntokë, duke lejuar përdorime rekreative në hapësirën e hapur në kuotën 0.0 të identifikuar si të tillë, zhvillimi lejohet duke ezauruar të drejtën e përdorimit të të drejtave të zhvillimit të parcelës diku tjetër”, dhe;

shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: “Në vijim të pikës 5 të këtij neni, rastet kur zhvillimi privat i një zone zhvillimi/hiënnjësie strukturore brënda të njëjtës njësie strukturore, apo të një njësie tjetër që ka të miratuar PDV për njësinë përkatëse,





shpreh interesin e menaxhimit të një zone të identifikuar si "zonë T", e cila është përfshirë në program transferimi nga autoritetet vendore të BT, atëherë bashkëpunimi mes palëve lejohet. Në këto raste, zhvillimi mes dy zonave do të trajtohen në procedurën normale të sipërmarrjes dhe menaxhimit të pronave sipas planit të menaxhimit të pronave për të dyja zonat përkatëse (Rizhvillim dhe Transferim) dhe do të hartohej PDV fazë e dytë në respektim të kushteve të zhvillimit dhe kondicioneve ligjore sipas procedurës standarde për zhvillim".

Në vijim, pikat "5, 6, 7, 8, 9 dhe 10" ndryshojnë numërimin respektivisht në pikat "7, 8, 9, 10, 11 dhe 12".

Pika 6 ndryshuar numërimin në pikën 8, pas fjalëve "...apo kjo irregulllore...", hiqet fjalë "...zhvillimi...", dhe pas fjalëve "...njësisë përkatëse...", shtohen fjalët "...për ato njësi subjekt PDV-je...".

Pika 10, ndryshuar numërimin në pikën 12, në fund, pas fjalëve "...kuadrit ligjor në fuqi...", shtohen fjalët "...dhe kushtet e zhvillimit të dhëna për njësinë përkatëse do të jenë kufizuese për pronat subjekt i këtij rasti përjashtimor.".

- **NENI 9**

Në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 35, pas fjalëve "...të posaçëm në fuqi.", shtohen fjalët "...Të gjitha përdorimet "M - monument" përfshihen në konservim, për të cilat lejohen vetëm ndërhyrje ristrukturimi me qëllim rivlerësimi të strukturave ekzistuese, pa ndryshime në volume apo karakteristikave të gjuhës urbane dhe arkitektonike. Në këto raste, shtesat anësore lejohen në pjesët e pasme të strukturave. Në rastin e ndërhyrjes në struktura të përdorimit të lejuar "M" të cilat janë pjesë e listes së monumenteve të kulturës, ndërhyrjet do të lejohen vetëm sipas udhëzimeve të LAK dhe strukturave përgjegjëse përkatëse.

Për parcelat private që shtrihen kryesisht në zonat e përdorimit "M", lejohen të drejta zhvillimi në trajtën e "Konsolidimit urban" sipas parashikimeve të pikës 2/b të këtij neni, me kushtin e respektimit të kushteve të zhvillimit dhe tipologjisë arkitektonike dhe urbane të objekteve kufitarë, brënda zonës "M".".

- **NENI 10**

Në pikën 4, të nenit 38, pas fjalëve "...me leje zhvillimi apo ndërtimi..", shtohet fraza "pa miratimin e planit të detajuar vendor..." dhe pas fjalisë së parë, shtohet fjalia "Në rastet kur lejet e zhvillimit lëshohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, miratimi i planit të detajuar vendor nuk përbën kusht për dhënien e lejes së zhvillimit, por në çdo rast duhet të shoqërohet nga rregullorja e veçantë.".

Në pikën 5, të nenit 38, pas fjalëve "...përcaktimëve të kësaj rregullore..", bëhen këto ndryshime: "Në rastet kur hapësirat e hapura kanë prona private në territoret e tyre, për këto prona rezervohet intensitetit proporcional në nivel zone, në mënyrë që në perspektivë të mundësohet procedura e transferimit të të drejtës për zhvillim apo menaxhimit të tyre, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe rekomandimeve të këtij plani të përgjithshëm vendor.".

- **NENI 11**

Në nenin 39, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 4, pas fjalëve "...dhe sheshe ekzistuese.", shtohen fjalët "...të formuara, ...".

Në pikën 5, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përbajtje: "Në këto struktura nuk do të rezervohen sipërsfaqe ndërtimi për shesa në volume gjatë hartimit të PDV-



së. Shtesat volumetrike do të konsiderohen sipas qëndrueshmërisë fizike të strukturës gjatë procesit të ristrukturimit, sipas parashikimeve të nenit 55 të kësaj rregulllore.”

Në pikën 6, pas fjalëve “...të kësaj rregulllore...”, shtohen fjalët “...apo në raste të veçanta, me intensitet ekzistues më të lartë se intensiteti i propozuar.”

Në pikën 7, pas fjalëve “...të bëhet bazuar...”, shtohen fjalët “...në kufijtë e pronave,...”

Në pikën 8, hiqet fjala “kryesisht” dhe në vend të saj shtohet fjala “edhe” dhe pas fjalëve “...nga zonat e zhvillimi...”, fjala “edhe” ndryshon në “dhe”.

- **NENI 12**

• Në pikën 1, të nenit 44, pas fjalëve “...ndihmëse funksionale..” shtohet fjala “dhe”.
Në pikën 1, shkronja “a”, të nenit 44, fjalët “...intensitetin e ndërtimit 0.03...” bëhen “...intensitetin e ndërtimit 0.3...”.

- **NENI 13**

Në nenin 46, bëhen këto ndryshime:

Pas pikës 2, shtohet pika 3 këtë përmbajtje: “Në respektim të përcaktimit proceduriale të këtij neni, lejohen shtesa anësore në struktura ekzistuese një-familjare, deri në plotësim të kushteve të zhvillimit sipas pikës 2 të këtij neni.”

Në vijim, pikat “3 dhe 4” ndryshojnë numërimin respektivisht në pikat “4 dhe 5”.

- **NENI 14**

Në nenin 48, bëhen këto ndryshime:

Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje: “KSHT-ja për kategoritë banim për njësitë strukturore pjesë të zonave urbane lejohet deri në masën 45%, për njësitë strukturore pjesë të zonave sub-urbane dhe rurale rekomandohet deri në masën 30%.”

Pika 6 ndryshon me këtë përmbajtje: “KSHT-ja maksimale e lejuar për kategorinë e shërbimeve në territor, pjesë të zonave urbane, lejohet deri në masën 45% për territorin sub-urban dhe rural rekomandohet të jetë deri në masën 30%, ndërsa për kategorinë e ndërtimeve në funksion të përdorimit industri dhe ekonomi është 70%”

Në pikën 11, pas fjalëve “...strukturat e përkohshme...”, shtohen fjalët “...strehë të tejdukshme apo arkada, të pashfrytëzueshme...” dhe pas fjalëve “...sistemimet e terrenit...”, shtohen fjalët “...terracat, rampat, ...”.

Në pikën 13, pas fjalëve “...të pallateve shumëfamiljare...”, shtohen fjalët “...të ndërtuara para viteve 90...”.

- **NENI 15**

Në pikën 4, të nenit 50, ndryshohet fjala “KSHR” me fjalën “KSHP” dhe pas saj shtohen fjalët “...Përjashtim nga kushtet e kësaj pike dhe këtij neni bëjnë rastet e rizhvillimit të strukturave shumë-familjare sipas parashikimeve të nënët 48/13.”.

- **NENI 16**

Në pikën 4, të nenit 51, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Për çdo zonë zhvillimi, në respektim të kushteve të kësaj pike, intensiteti i përfshuar nga analiza sipas pikës 3 të këtij neni, nuk do të përcaktohet në asnjë rast më pak se 80% e intensitetit të ndërtimit të parashikuar nga plani për njësinë strukturore.”

Pas shkronjës “d”, në pikën 10, të nenit 51 shtohet pika “e” me këtë përmbajtje: “Në rastet përjashtimore të rizhvillimit të strukturave shumë-familjare/pallate, sipas parashikimeve të nenit 52/12 dhe 48/13, për pjesën e pronës së pallatit, intensiteti i ndërtimit do të llogaritet me formulën Iekz*2.5 (ku Iek është Intensiteti ekzistues i



strukturës). Përjashtim nga parashikimet e këtij nenit bëjnë njësitë strukturore me intensitet të propozuar mbi 4.”.

- **NENI 17**

Në nenin 52, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 6, pas fjalëve “...minimum i parashikuar.”, shtohen fjalët “...apo të rasteve të përcaktuara nga PPV.”.

Pika 8, ndryshon me këtë përbajtje: “Në rastet e stimulimit të një lloji të caktuar të zhvillimit, sipas parashikimeve të rasteve përjashtimore të neneve 54 dhe 79 të kësaj rregullore në respektim të nenit 35 të VKM 408 (i ndryshuar), distancat objekt-objekt si dhe objekt-kufi prone do të përcaktohen nga dokumenti i detajuar i planifikimit vendor apo nga leja e zhvillimit përkatëse në shqyrtim.”.

Pika 9, ndryshon me këtë përbajtje: “Në rastet kur zhvillimi i propozuar përballet me strukturë ekzistuese, të ndërtuar pa leje ndërtimi apo në shkelje te kushtetëse të lejes së miratuar nga autoriteti vendor i planifikimit, propozimi për zhvillim përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat me pjesën informale (shtesë anësare dhe/ose kati). Në këto raste struktura e re e propozuar do të respektojë distancat vetem më lejen e miratuar në rastet kur përballet me situatë të formuar, apo me kufirin e pronës në rastet kur përballet me objekte të ndërtuara tërësisht pa leje”.

Pas pikës 9, shtohet pika 10, me këtë përbajtje: “Në rastet e shtimit në lartësi sipas parashikimeve të nenit 54/4 të kësaj rregullore vendore, katet shtesë subjekti i kushteve të këtij nenit, nuk do t'i nënshtrohen treguesve të distancave objekt-objekt dhe objekt-kufi prone, por do të përcjellin në lartësi siluetën e shkallëzimit të katit më të lartë të kushtëzuar nga përcaktimet ligjore të treguesve të distancave. Në këto raste, referuar përcaktimeve të kësaj pike dhe të pikës 8 të këtij nenit, katet apo strukturat e realizuara sipas parashikimeve të rregullave të veçanta, përjashtohen nga llogaritja e treguesve të distancave për strukturat e reja që do të përballen me to.”.

Pika 10 ndryshon numërimi në pikën 11.

Pikat “11, 12, 13 dhe 14” ndryshojnë numërimin respektivisht në pikat “12, 13, 14 dhe 15”.


- **NENI 18**

Në nenin 54, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 3, pas fjalëve “...formuar në territor.” shtohet fjalia “Përjashtim nga kushtet e kësaj pike bëjnë ato raste të strukturave lineare apo blloqeve komplekse, të strukturave në terrene të pjerrta, etj, ku për shkak të dinamikës volumetrike, arkitekturës apo përshtatjes me terrenin kërkohet realizimi i lartësive më të ulta se parashikimet e planit për njësinë përkatëse”.

Në pikën 4, pas fjalëve “...deri në 3 kate...”, shtohet fjalë “...edhe...”, pas fjalëve “...të distancave, sipas...”, shtohet fjalë “...lartësisë të realizuar apo...”dhe, në fund shtohet paragrafi me këtë përbajtje: “Kushtet e kësaj pike për maksimalizimin e hapësirave të hapura me përdorim publik, lejohen vetëm për territorin urban të kryeqytetit. Përjashtim nga ky rregull bëjnë kategoritë e përdorimit IS dhe SH për përdorim publik, si dhe strukturat e ulta të përdorimit banim të të gjitha zonave me kushtin e moskalimit të lartësisë maksimale prej 3 kate total mbi tokë.”.

Në pikën 5, në nënnpikën e identifikuar me gërmën “b”, numri “..3..” bëhet “..4..”



Në pikën 7, pas nënnpikës të identifikuar me gërmën "b", shtohet gëрма "c" me këtë përbajtje: "Përjashtim nga parashikimet e këtij nenit apo të lartësisë të përcaktuar në pasaportën përkatëse të njësisë, bëjnë ato raste të cilat parashikojnë rizhvillimin e strukturave shumë-familjare, sipas parashikimeve të nenit 48/13 të kësaj rregullore". Pika 9 riformulohet si vijon: "Të gjitha strukturat duhet të respektojnë kushtet e distancave nga strukturat dhe kufiri i pronës sipas parashikimeve të kësaj rregullore vendore".

- **NENI 19**

Në nenin 55, bëhen këto ndryshime:

Pika 3 riformulohet si vijon: "Në rastet kur ristrukturimi i strukturës ekzistuese parashikon zhvillimin apo shtimin pjesor volumetrik anësor apo në lartësi, të strukturave ekzistuese në territor, propozimi do të shoqërohet gjatë aplikimit për Leje Ndërtimi, me vendosjen e strukturës të propozuar për shtim apo plötësim të volumetrisë ekzistuese në raport me volumetrinë urbane ekzistuese, duke pasqyruar në plan dhe volumetri impaktin urban të propozimit sipas kushteve ligjore të distancave apo shfrytëzimit të territorit në suqi.

Në rastin e shtesave në lartësi nuk lejohen shtesa më shumë se 1 kat, më shumë se njëherë, mbi lartësinë ekzistuese të strukturës dhe nuk lejohen shtesa mbi lartësinë në kate të përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore. Në respektim të kushteve të kësaj pike, intensiteti i ndërtimit nuk llogaritet vetëm për rastet e shtesës së kateve apo të ndryshimit të llojit të mbulimit në struktura ekzistuese. Pa rënë ndesh me pikën 6 të këtij nenit, për të gjitha rastet e tjera, në strukturat e mesme dhe të larta të territorit të hierarkisë urbane, shtesat e katit lejohen vetëm me kushtin e mylljes së një kallkani pjesor në shtesë ekzistuese dhe respektimit të pikës 6 të këtij nenit".

Pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përbajtje: "Në referencë të pikës 3 të këtij nenit, për strukturat e ulta në njësitë për rizhvillim urban subjekt PDV, shtesa e katit lejohet me kushtin e respektimit të formulës: Nr.kate+1 < Nr.kate PPV/2, (ku "Nr.kate" është numri i kateve ekzistues të strukturës, ndërsa "Nr.kate PPV" është numri i kateve të propozuar nga plani).".

Në fund të pikës 6, shtohet fjalia "Në respektim të përcaktiveve të kësaj pike, shtesat anësore gjatë ristrukturimit të strukturës ekzistuese për vendosjen e shkallëve të emergjencës apo ashensorëve, konsiderohen konsolidimi i strukturës dhe do të respektojnë përcaktimet proceduriale të mënyrës së ndërhyrjes me konsolidim, sipas përcaktiveve të kësaj rregullore".

Pikat "4, 5, 6, 7, 8 dhe 9", ndryshojnë numërimin respektivisht në pikat "5, 6, 7, 8, 9 dhe 10".

- **NENI 20**

Pika 1 e nenit 56 ndryshon me këtë përbajtje: "Në të gjitha ato territorë të mundshme për zhvillim, që ballafaqohen me struktura ekzistuese të formuara me faqe kallkan, për të kryer mylljen e situatës ekzistuese urbane në territor, lejohet zhvillim nëpërmjet konsolidimit, duke qënë se kallkani ka krijuar konceptin e vazhdimësisë në territor të siluetës së formuar urbane. Në zbatim të kësaj pike kur është e nevojshme, lejohen të drejta zhvillimi të njëjta me ato të strukturës ekzistuese për realizimin e konsolidimit urban në territor."



- **NENI 21**

Në pikën 2, të nenit 78, pas fjalëve “...partneritetit publik – privat...”, shtohen fjalët “...sipas hartës të gjelbërimit të propozuar nga ky plan i përgjithshëm vendor. Në rastet kur sipërfaqet e parashikuara si parqe periferike, u mbivendosen përdorimeve të sistemit urban, zhvillimet do të lejohen me kushtin e mbjelljeve masive në territor...”.

- **NENI 22**

Në nenin 79, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 5, fjala “2 vitesh” ndryshon në fjalën “4 vitesh”.

Pika 12 riformulohet si vijon “Në rastet kur propozimi per zhvillim, pozicionimi i strukturave në territor dhe projekti arkitektonik i tyre vlerësohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit apo nga Bashkia Tiranë me konkurs të hapur ndërkombëtar, për stimulimin e një lloji të caktuar zhvillimi, atëherë këto struktura dhe parcelat në funksion të tyre mund të përjashtohen nga hartimi i planeve të detajuara vendore si dhe nga llogaritja e treguesve të zhvillimit për njësinë përkatëse si dhe nga kushtet e planifikimit të parashikuara sipas neneve 48 deri 57 të kësaj rregulllore apo rregullave të kushteve të distancave sipas nenit 52 të kësaj rregulllore në respektim të nenit 35 të “Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, miratuar me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 (e ndryshuar). Në këto raste, propozimi do të vlerësohet në formatin e aplikimit për leje zhvillimi dhe hapja e konkursit ndërkombëtar duhet të miratohet nga autoritetet vendore të cilat do të përbëjnë dhe shumicën e jurisë të vlerësimit për çdo rast”.

Pas pikës 14, shtohet pika 15 me këtë përbajtje: “Projekt idetë arkitektonike të miratuara me Leje Zhvillimi, lejohet të ndryshohen direkt në Leje Ndërtimi apo nëpërmjet procesit të “Rishikimit të Kushteve të Lejes”, pa patur nevojën e rishikimit të projektit në leje zhvillimi, me kushtin e respektimit të kushteve të zhvillimit të miratuara.”.

Pika “15” ndryshon emërtim dhe bëhet pika “16”.



KREU II
NDRYSHIME NË HARTËN E PËRDORIMIT TË TOKËS DHE NË TABELAT
PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTURORE.

Në "Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë", bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon.

Paraqitura grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas imazheve dhe koordinatave në *Shtoja I* dhe *Shtoja II* të këtij dokumenti.

1. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/1

- Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga "1981.4 ha", ndryshon në "2003.04 ha".
- Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshojnë nga "N"- Natyrë (93%), "B" - Bujqësi (7%), "A" - Banim (1%), në "N"- Natyrë (93%), "B" - Bujqësi (6%) dhe "A" - Banim (1%).

2. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/11

- Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga "64.02 ha", ndryshon në "70.6 ha".
- Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga "N"- Natyrë (55%), "B" - Bujqësi (41%), "A" - Banim (3%), në "N"- Natyrë (53%), "B" - Bujqësi (44%) dhe "A" - Banim (3%).

3. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/18

- Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga "1228.22 ha", ndryshon në "1403.39 ha".
- Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga "N"- Natyrë (94%), "B" - Bujqësi (5%), "A" - Banim (1%), në "N"- Natyrë (95%), "B" - Bujqësi (4%) dhe "A" - Banim (1%).

4. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/47

- Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga "90.84 ha", ndryshon në "98.58 ha".
- Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga "N"- Natyrë (90%), "B" – Bujqësi (9%) dhe "A" - Banim (1%), në "N"- Natyrë (46%), "B" – Bujqësi (42%) dhe "A" - Banim (9%) dhe "U" – Ujëra (3%).

5. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/49

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "N"- Natyrë (90%), "B" – Bujqësi (9%) dhe "A" - Banim (1%), ndryshon në "N"- Natyrë (88%), "B" - Bujqësi (9%), "U" - Ujëra (2%) "A" - Banim (1%).

6. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/51

- Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga "1543.57 ha", ndryshon në "1615.95 ha"
- Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga "N"- Natyrë (95%), "B" - Bujqësi (5%), në "N"- Natyrë (95%), "B" - Bujqësi (4%) dhe "A" - Banim (1%).



7. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/52

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “14.03 ha”, ndryshon në “12.45 ha”.
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (76%), “B” - Bujqësi (24%), në “N”- Natyrë (73%), “B” - Bujqësi (26%) dhe “V” - Përdorim i Veçantë (1%).

8. Në pasaportën e njësisë strukturore BA/53

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “553.86 ha”, ndryshon në “578.03 ha”.
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga nga “B” - Bujqësi (49%), “N”- Natyrë (43%), “A” - Banim (7%) dhe “U” - Ujëra (1%), në “N”- Natyrë (64%), “B” - Bujqësi (28%), “A” - Banim (7%) dhe “U” - Ujëra (1%).

9. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/12

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “406.5 ha”, ndryshon në “477 ha”.
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (93%), “B” - Bujqësi (7%), në “N”- Natyrë (94%), “B” - Bujqësi (5%) dhe “A” - Banim (1%).

10. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/30

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, nga “B”- Bujqësi (47%), “S” – Shërbime (46%), “IN” - Infrastrukturë (5%) dhe “U” – Ujëra (2%), ndryshon në “S” – Shërbime (47%), “B”- Bujqësi (46%), “IN” - Infrastrukturë (5%) dhe “U” – Ujëra (2%).
- b) *Shtohet kategoria e përdorimit të tokës “IE+S”* - Industri dhe Ekonomi + Shërbime, si kategori e pestëmë pak se 1%.

11. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/33

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, nga “B”- Bujqësi (46%), “N”- Natyrë (44%), “A” - Banim (11%) dhe “IN” - Infrastrukturë (0%), ndryshon në “B”- Bujqësi (45%), “N”- Natyrë (43%), “A” - Banim (12%) dhe “IN” - Infrastrukturë (0%).

12. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/62

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “99.56 ha”, ndryshon në “155.28 ha”.
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (56%), “B” - Bujqësi (44%), në “N”- Natyrë (65%), “B” - Bujqësi (32%) dhe “U”- Ujëra (3%).

13. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/63

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “121.04 ha”, ndryshon në “209.28 ha”.
- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (90%), “B” - Bujqësi (9%) dhe “U” - Ujëra (1%), në “N”- Natyrë (94%), “B” - Bujqësi (5%) dhe “U” - Ujëra (1%).

14. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/64

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “135.26 ha”, ndryshon në “203.19 ha”.



- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (65%), “U” - Ujëra (19%) dhe “B” - Bujqësi (16%), në “N”- Natyrë (76%), “U” - Ujëra (14%) dhe “B” - Bujqësi (10%).

15. Në pasaportën e njësisë strukturore BE/65

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “214.54 ha”, ndryshon në “201.94 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (96%), “U” - Ujëra (2%) dhe “B” - Bujqësi (2%), në “N”- Natyrë (97%), “U” - Ujëra (2%) dhe “B” - Bujqësi (1%).

16. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/1

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “173.81 ha”, ndryshon në “54.89 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “N”- Natyrë (76%), “B” - Bujqësi (24%), në “N”- Natyrë (76%), “B” - Bujqësi (23%) dhe “A” - Banim (1%).

17. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/28

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga N- Natyrë (84%), “B”- Bujqësi (12%) dhe “A”- Banim (4%), ndryshon në N- Natyrë (82%), “B”- Bujqësi (12%) dhe “A”- Banim (6%).

18. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/42

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “9.16 ha”, ndryshon në “6.16 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “U”- Ujëra (73%), “A” - Banim (24%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%), në “U”- Ujëra (83%), “A” - Banim (14%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%).

19. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/43

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “2.97 ha”, ndryshon në “2.11 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “A” - Banim (76%) dhe “N”- Natyrë (24%), në “A” - Banim (59%) dhe “N”- Natyrë (41%).

20. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/45

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “13.26 ha”, ndryshon në “13.27 ha”.

21. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/52

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “15.77 ha”, ndryshon në “14.33 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, nga “A” - Banim (53%), “A+S” – Banim dhe Shërbime (35%) , “B” – Bujqësi (8%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%), ndryshon në “A” - Banim (55%), “A+S” – Banim dhe Shërbime (35%), “B” – Bujqësi (4%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%).

22. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/68

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “4.23 ha”, ndryshon në “2.98 ha”.



- b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, ndryshon nga “IE”- Industri dhe Ekonomi (84%), “B” - Bujqësi (16%), në “IE”- Industri dhe Ekonomi (77%), “B” - Bujqësi (22%) dhe “A” - Banim (1%).

23. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/74

- a) *Sipërfaqja e njësisë strukturore* nga “14.57 ha”, ndryshon në “16 ha”.
b) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, nga “A”- Banim (91%), “N”- Natyrë (6%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%), ndryshon në “A”- Banim (91%), “N”- Natyrë (5%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%).

24. Në pasaportën e njësisë strukturore DA/79

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës*, nga “A” – Banim (85%), “N”- Natyrë (11%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%), ndryshon në “A” – Banim (81%), “AS” – Arsim (9%), “N”- Natyrë (6%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%).
b) Percaktimi per “Subjekt PDV” ndryshon nga ‘JO’ ne ‘PO’.

25. Në Pasaportën e njësisë strukturore FA/1

Percaktimi per “Subjekt PDV” ndryshon nga ‘JO’ ne ‘PO’.

26. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/16

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B”- Bujqësi (86%), “A”- Banim (12%), “IN” - Infrastrukturë (2%) dhe “V” – Përdorim i Veçantë (1%), ndryshon në “B”- Bujqësi (81%), “A”- Banim (16%), “IN” - Infrastrukturë (2%) dhe “V” – Përdorim i Veçantë (1%).

27. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/18

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B” – Bujqësi (68%) dhe “A” - Banim (32%), ndryshon në “B” – Bujqësi (66%) dhe “A” - Banim (34%).

28. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/23

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A”- Banim (80%), “N”- Natyrë (16%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%), ndryshon në “A”- Banim (86%), “N”- Natyrë (10%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%).

29. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/24

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A” - Banim (100%), ndryshon në “A” - Banim (98%), “B” - Bujqësi (1%) dhe “N” - Natyrë (1%).

30. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/27

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A”- Banim (86%) dhe “B”- Bujqësi (14%), ndryshon në “A”- Banim (88%) dhe “B”- Bujqësi (12%).



39. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/54

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga B” - Bujqësi (96%), “IN” - Infrastrukturë (3%) dhe “A” - Banim (2%), ndryshon në “B” - Bujqësi (73%), “A” - Banim (24%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%).*
- b) *Intensiteti i ndërtimit nga “0.3”, ndryshon në “0.6”*

40. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/56

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A” - Banim (53%) dhe B” - Bujqësi (47%), ndryshon në “A” - Banim (57%) dhe B” - Bujqësi (43%).

41. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/59

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B” - Bujqësi (63%), “A” - Banim (31%) dhe “IN” - Infrastrukturë (6%), ndryshon në “B” - Bujqësi (64%), “A” - Banim (27%), “IE” - Industri dhe Ekonomi (5%) dhe “IN” - Infrastrukturë (4%).

42. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/60

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës, ndryshon nga “B” - Bujqësi (87%), “A” - Banim (10%), “V” - Përdorim i Veçantë (1%) dhe “IN” - Infrastrukturë (1%), në “B” - Bujqësi (86%), “A” - Banim (11%), “V” - Përdorim i Veçantë (1%) dhe “IN” - Infrastrukturë (1%).*
- b) *Kategoria e përdorimit të tokës “AS” – Arsim (1%), është kategoria e pestë e njësisë strukturore.*

43. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/61


Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A” - Banim (45%), “B” - Bujqësi (43%), “AS” - Arsim (10%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%), ndryshon në “A” - Banim (70%), “B” - Bujqësi (17%), “AS” - Arsim (10%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%).

44. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/65

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A” - Banim (65%), “B” - Bujqësi (28%), “IN” - Infrastrukturë (4%) dhe “V” - Përdorim i Veçantë (3%), ndryshon në “A” - Banim (66%), “B” - Bujqësi (27%), “IN” - Infrastrukturë (4%) dhe “V” - Përdorim i Veçantë (3%).

45. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/67

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “A” - Banim (73%), “B” - Bujqësi (19%), “IN” - Infrastrukturë (5%) dhe “IE+S” – Industri Ekonomi dhe Shërbime (3%), ndryshon në “A” - Banim (72%), “B” - Bujqësi (17%), “IN” - Infrastrukturë (5%) dhe “IE” - Industri (5%).*
- b) *Kategoria e përdorimit të tokës “IE+S” – Industri Ekonomi dhe Shërbime (1%), është kategoria e pestë e njësisë strukturore.*



46. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/68

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "A" - Banim (95%) dhe "IN" - Infrastrukturë (5%), ndryshon në "A" - Banim (82%), "IE+S" – Industri Ekonomi dhe Shërbime (13%)dhe "IN" - Infrastrukturë (5%).

47. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/78

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga A" - Banim (65%), "B"- Bujqësi (30%) dhe "IN" - Infrastrukturë (5%), ndryshon në A" - Banim (85%), "B"- Bujqësi (10%) dhe "IN" - Infrastrukturë (5%).

48. Në Pasaportën e njësisë strukturore FA/79

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "A" - Banim (70%), "B" – Bujqësi (29%) dhe "IN" - Infrastrukturë (1%), ndryshon në "A" - Banim (71%), "B" – Bujqësi (28%), dhe "IN" - Infrastrukturë (1%).

49. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/80

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "A" - Banim (51%), "B" - Bujqësi (46%) dhe "IN" - Infrastrukturë (3%), ndryshon në "A" - Banim (52%), "B" - Bujqësi (45%) dhe "IN" - Infrastrukturë (3%).

50. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/81

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "B"- Bujqësi (90%), A" - Banim (8%), dhe "IN" - Infrastrukturë (2%), ndryshon në "B"- Bujqësi (89%), A" - Banim (9%) dhe "IN" - Infrastrukturë (2%).

51. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/88

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "N"- Natyrë (33%), "A" - Banim (32%), dhe "B" - Bujqësi (24%), ndryshon në "A" - Banim (71%), "B" - Bujqësi (24%) dhe "N"- Natyrë (5%).

52. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/89

- Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "A" - Banim (63%), "B" - Bujqësi (21%), "N"- Natyrë (11%) dhe "IN" - Infrastrukturë (5%), ndryshon në "A" - Banim (58%), "B" - Bujqësi (18%), "N"- Natyrë (11%) dhe "IE" – Industri dhe Ekonomi (8%).*
- Kategoria e përdorimit të tokës "IN" - Infrastrukturë (5%), është kategoria e pesëtë e njësisë strukturore.*
- Percaktimi per "Subjekt PDV" ndryshon nga 'JO' ne 'PO'.*

53. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/95

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga "B"- Bujqësi (95%) dhe "A"- Banim (5%), ndryshon në "B"- Bujqësi (93%) dhe "A"- Banim (7%).



54. Në Pasaportën e njësisë strukturore FA/96

Në mënyrat e ndërhyrjes në territor, shtohet “rizhvillimi”.

55. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/97

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B”- Bujqësi (98%), “A”- Banim (1%), “IN” - Infrastrukturë (1%), ndryshon në “B”- Bujqësi (75%), “A”- Banim (24%) dhe “IN” - Infrastrukturë (1%).

56. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/99

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B”- Bujqësi (80%), “A” - Banim (18%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%), ndryshon në “B”- Bujqësi (64%), “A” - Banim (33%) dhe “IN” - Infrastrukturë (3%).

57. Në Pasaportën e njësisë strukturore FA/102

Percaktimi per “Subjekt PDV” ndryshon nga ‘JO’ ne ‘PO’.



58. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/105

- a) *Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “IS+V” – Institucion + Përdorim i Veçantë (57%), “N” - Natyrë (33%), “IN” - Infrastrukturë (6%) dhe “A” - Banim (4%), ndryshon në “IS” – Institucion (57%), “N” - Natyrë (33%), “IN” - Infrastrukturë (6%) dhe “A” - Banim (4%).*

59. Në Pasaportën e njësisë strukturore FA/113

Percaktimi per “Subjekt PDV” ndryshon nga ‘JO’ ne ‘PO’.

60. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/120

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “N” - Natyrë (60%), “B”- Bujqësi (34%), A” - Banim (5%) dhe “AR” – Aktivitete Sociale dhe Rekreative (1%), ndryshon në “N” - Natyrë (57%), “B”- Bujqësi (33%), A” - Banim (9%) dhe “AR” – Aktivitete Sociale dhe Rekreative (1%).

61. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/123

Kategoritë e përdorimit të tokës, nga “B”- Bujqësi (78%), “A”- Banim (10%), “AR” – Aktivitete Sociale dhe Rekreative (10%) dhe “IN” - Infrastrukturë (1%), ndryshon në “B”- Bujqësi (52%), “A”- Banim (37%), “AR” – Aktivitete Sociale dhe Rekreative (10%) dhe “IN” - Infrastrukturë (1%).

62. Në pasaportën e njësisë strukturore FA/132

